REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

**Nr.3389 Prot.** **Lezhë 22.11.2021**

# URDHER

**Nr 156 datë 22.11.2021**

**PËR**

***SHPALLJEN E PROÇEDURAVE TË KONKURRIMIT "PËR PUNONJËS TË SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL NË JURIDIKSION TË DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË 2021"***

Ligjin 69/2012 datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.7961 dt.12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar, Urdhrit te Ministrit te Arsimit Sportit dhe Rinisë me Nr 31 datë 28.01.2020 "*Për Miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore*" Urdhrit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 313, datë 20.10.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e njësisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial",

## URDHËROJ:

1. **Shpalljen e proçedurave të konkurimit për punonjësit e Shërbimit psiko-social të DRAP Lezhë:**

- **ZYRA VENDORE ARSIMORE LEZHË**

| NR | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR | PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL | PROVIZOR /VAKANT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lezhë | Lezhë | SHMB "Llesh Nik Daka " Shënkoll | PSIKOLOG | VAKANT |
| 2 | Lezhë | Lezhë | SHMB ZEJMEN | PSIKOLOG | PROVIZOR deri më 09.01.2022 |

## ➢ ZYRA VENDORE ARSIMORE KURBIN

| NR | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR | PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL | PROVIZOR /VAKANT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | LEZHË | KURBIN | GJIMNAZI"AT'SHTJEFËN GJEÇOVI"LAÇ | PSIKOLOGE | PROVIZOR |
| 2 | LEZHË | KURBIN | GJIMNAZI MILOT | PSIKOLOGE | PROVIZOR |
| 3 | LEZHË | KURBIN | GJIMNAZI "ARIF HALIL SULAJ"MAMURRAS | PUNONJËSE SOCIALE | PROVIZOR |
| 4 | LEZHË | KURBIN | SHKOLLA 9 VJEÇARE "BESNIK SYLA" KOPSHTI NR.2 MAMURRAS | PSIKOLOG | VAKANT |
| 5 | LEZHË | KURBIN | SHKOLLA 9 VJEÇARE "DAN BAJRAMI"GJORËM, "FRAN PAL PIROLI" ZHEJË, FUSHË KUQE. | PSIKOLOG | VAKANT |

## ➢ ZYRA VENDORE ARSIMORE SHKODËR

| NR | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR | PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL | PROVIZOR /VAKANT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lezhë | Lezhë | Adem Haxhija" | Psikolog | Vakant |
| 2 | Lezhë | Lezhë | Salo Halili" | Psikolog | Provizor (leje lindje) |

## ➢ ZYRA VENDORE ARSIMORE KUKËS

| NR | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR | PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL | PROVIZOR /VAKANT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1 | Lezhe | Shkolla MB " Shishtavec"<br>Kopshti nr 2ukes | Psikolog | VAKANT |
| 2 | 2 | Lezhe | Shkolla MB " Bushtrice"<br>Sali Bruka " Malqene"<br>Gjimnazi " Bajram Abdiu", Bicaj<br>" Shaban Murati" Lusen | Psikolog | VAKANT |

## ➢ ZYRA VENDORE ARSIMORE MIRDITË

| NR | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR | PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL | PROVIZOR /VAKANT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lezhe | Mirdite | 9-Vjecare Pashko Vasa | Psikolog | Vakant |

## ➢ ZYRA VENDORE ARSIMORE HAS

| NR | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR | PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL | PROVIZOR /VAKANT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | LEZHË | HAS | Gjimnazi "Skënderbeu" Krumë | 1 Punonjës Social | VAKANT |
| 2 | LEZHË | HAS | Shkolla 9-vjeçare "Sejdi Dida" Krumë | 1 Psikolog | VAKANT |
| 3 | LEZHË | HAS | Shkolla e Mesme e Bashkuar "Arif Zeqir Brati" Golaj | 1 Psikolog | VAKANT |
| 4 | LEZHË | HAS | Shkolla 9-vjeçare "Liman Mazrreku" Vranisht | 1 Psikolog | VAKANT |

## ➢ ZYRA VENDORE ARSIMORE PUKË

| NR | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR | PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL | PROVIZOR /VAKANT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lezhë | Pukë | PjeterArbnori | Psikolog | Vakant |
| 2 | Lezhë | Pukë | Migjeni | Psikolog | Vakant |
| 3 | Lezhë | Pukë | Gjimnazi "Sabah Sinani" | Psikolog | Vakant |

## ➢ ZYRA VENDORE ARSIMORE TROPOJË

| NR | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR | PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL | PROVIZOR /VAKANT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | LEZHË | TROPOJË | ALI IBËR NEZA , HOXHË ZOGU, MURAT PACI, HAXHI ZENUNI, XHELADIN GOSTURANI | **PSIKOLOG** | **VAKANT** |
| 2 | LEZHË | TROPOJË | MATOSH UKA , TINKA KURTI , OSO DAUTI , JAHO SALIHI | **PSIKOLOG** | **VAKANT** |

## ➢ ZYRA VENDORE ARSIMORE MALËSI E MADHE

| NR | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR | PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL | PROVIZOR /VAKANT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | LEZHË | MALËSI E MADHE | SHKOLLA 9 VJEÇARE"VASIL SHANTO"VRAKË | PSIKOLOG | PROVIZOR |

## I. Kriteret për t`u punësuar në shërbimin psikosocial:

**A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos jetë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative, apo vërejtje në fuqi.

**B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:**

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse.
3. Njohuri bazë në kompjuter.
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi,certifikata).
5. Aftësi komunikuese dhe punës në grup.

## II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

**A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

1. Përshkrimi i edukimit dhe karrierës profesionale – Jetëshkrimin (Currculum vitae) sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 **(e detyrueshme);**
2. Kërkesë për (pjesëmarrje në konkurrim) për punësim në zyrën arsimore ku dëshirojnë të aplikojnë për për pozicionin psikolog / punonjës social (**e detyrueshme);**
3. Raport mjekoligjor i tri muajve të fundit **(i detyrueshëm);**
4. Kopje e njehsuar me origjinalin e Diplomës/diplomave (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhsimi nga Ministria e Arsimit **(e detyrueshme);**
5. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master **(e detyrueshme);**
6. Leje për ushtrimin individual të profesionit - kopje e njehsuar me origjinalin **(licencë);**
7. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga aplikanti sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 **(e detyrueshme);**
8. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 **(e detyrueshme);**
9. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës së arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
10. Librezë pune fotokopje e noterizuar nëse ka;
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale e tre muajve të fundit **(e detyrueshme);**
12. Dëshmi penaliteti **(e detyrueshme);**

13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar ( **detyrueshme).**

B. **Të gjithë dokumentat që janë fotokopje duhet të jenë të noterizuara. Nëse në dosjen e aplikimit mungon një nga dokumentat e detyrueshme atëherë kandidati skualifikohet automatikisht.**

*C.* **Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Lezhë, për të gjithë kandidatët që aplikojnë për punësim në ZVAP-et në varësi të DRAP Lezhë, përkatëse brenda afatit 22.11.2021 - 02.12.2021.**

III. **Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social të paraqitur në dosje, do të kryhet nga komisioni në periudhën 03.12.2021 – 07.12.2021.**

- **Rezultatet paraprake të vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen** në këndin e njoftimeve të institucionit arsimor **dhe në faqet zyrtare të ZVAP-ve dhe DRAP Lezhë në datë 07.12.2021 ;**
- **Kandidatët dërgojnë me e-mail ankesat në adresën zyrtare të DRAP Lezhë (DRAPLezhe@arsimi.gov.al) brenda datës 10.12.2021 .**
- **Në datë 10.12.2021 shpallet lista përfundimtare e kandidatëve që kalojnë fazën e parë ( I ) të shqyrtimit të dokumentacionit .**
- **Në datë 13.12.2021 DRAP Lezhë, njofton çdo kandidat të listës përfundimtare** lidhur me mjedisin, vendin dhe orën e zhvillimit të testimit.

**IV.** Testimi me shkrim për vlerësimin e njohurive të profesionit dhe për njohuritë mbi legjislacionin që lidhet me ushtrimin e profesionit, për kandidatët që kanë kaluar vlerësimin me dosje, do të zhvillohet në datën **14.12.2021, ora 10:00.**

- Shpallja e rezultateve paraprake te testimit është data **17.12.2021**.
- **Kandidatët dërgojnë me e-mail ankesat në adresën zyrtare të DRAP Lezhë (DRAPLezhe@arsimi.gov.al) brenda datë 21.12.2021 mbi vlerësimin e testimit.**

V. DRAP Lezhë brenda datës **23.12.2021** shpall listën e kandidatëve të kualifikuar dhe grafikun e intervistave të strukturuara me kandidatët që janë kualifikuar me testimin me shkrim me të paktën 50% të pikëve të testit me shkrim.

VI. Në përfundim të intervistës, komisioni ad-hoc shpall listën e kandidatëve për psikologë dhe listën e kandidatëve për punonjës-social në nivel DRAP-i, të renditur sipas pikëve gjithsej, (pikët e dosjes + pikët e testimit + pikët e intervistës). Lista me rezultatet përfundimtare i dorëzohet drejtorit të DRAP-it, i cili e publikon me ID përkatëse në faqen e institucionit.

***Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë***

**DREJTORI**

**BARDHOK PULAJ**

Adresa: Sheshi "Gjergj Kastrioti" Tel&fax.021522259 http://darlezhe.edu.al email: darlezhe@arsimi.al